

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7918, DATË 13.4.1995, “PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1030, DATË 23.2.1995, “PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKËVE TË PRIVATIZIMIT)”, DHE DEKRETIT NR.1049, DATË 27.3.1995, “PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR.1030, DATË 23.2.1995”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ndryshimi që propozohet të bëhet në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995, “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)”, dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995, “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995”, të ndryshuar, vjen në vijim të angazhimit të marrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.12770/5 prot., datë 4.11.2021, në përgjigje të kërkesës së Avokaturës së Shtetit lidhur me dhënien e zgjidhjes përfundimtare të rasteve kur shteti shqiptar ka detyrim kthimin e bonove të privatizimit në zbatim të një vendimi gjykate. Gjithashtu, ky ndryshim do të shërbejë edhe në funksion të politikave të Këshillit të Ministrave për të krijuar lehtësime në procesin e privatizimit me të drejtë parablerjeje për ish-pronarët e truallit, si dhe subjektet që kanë objekte me kontrate qiraje apo enfiteoze, si dhe në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale nëpërmjet ASHK-së.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TE TJERA POLITIKE

Ky projektligj lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshim i propozuar do të shërbejë edhe në funksion të politikave të Këshillit të Ministrave për të krijuar lehtësime në procesin e privatizimit me të drejtë parablerjeje për ish-pronarët e truallit, për subjektet që kanë objekte me kontratë qiraje apo enfiteoze, si dhe në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale nëpërmjet ASHK-së.

Meqenëse në procesin e privatizimit të pronës shtetërore ende vazhdon të mos jetë përfshirë një numër i konsiderueshëm objektsh kryesisht në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural apo dhe të organeve të pushtetit vendor etj., si dhe duke gjykuar se shumë prej këtyre objekteve shtrihen në pronat e ish-pronarëve të njohur apo kthyer me vendime të kthimit dhe kompensimit të pronave, mendojmë se mund të vazhdojnë lehtësirat për ish-pronarët, duke e likuiduar një pjesë të vlerës së këtyre objekteve në rast parablerjeje me bono privatizimi (lekë privatizimi).

Gjithashtu, përdorimi i bonove të privatizimit dhe i lekëve të privatizimit në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje nëpërmjet ASHK-së, ndërkohë që ky proces është në vazhdimësi dhe vazhdojnë të jenë në proces legalizimi një numër i konsiderueshëm objektsh apo banesash, gjykojmë se edhe ky proces e bën të domosdoshëm shtyrjen e afatit të përdorimit të bonove të privatizimit dhe të lekëve të privatizimit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me rendin juridik të brendshëm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrim me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon përdorimin e bonove të privatizimit dhe të lekëve të privatizimit në procesin e privatizimit të pronës shtetërore, në llogaritjen e formulës së privatizimit për punonjësit në shoqëritë aksionare dhe në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e zbatimin e këtij ligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar e propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

KËSHILLI I MINISTRAVE